FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 118

Tiranë – E premte, 16 gusht 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11252, datë 7.8.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	8787
Dekret i Presidentit nr. 11253, datë 7.8.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	8787
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 13.8.2019	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar	8787
Urdhër ministrit të Drejtësisë nr. 405, datë 5.8.2019	Për delegim kompetence	8788
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 112, datë 22.7.2019	Mbi modifikimin e licencës së shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k, nr. 158, seria pv12k, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 65, datë 28.5.2012, "Për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: "Darsi 1" me kapacitet 2240 kw, "Darsi 2" me kapacitet 7633 kw, "Darsi 3" me kapacitet 1066 kw, me kapacitet total 10939 kw	8788
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 113, datë 22.7.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Irarba Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Shëngjun" me kapacitet të instaluar 2040 kw	8790
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 114, datë 22.7.2019	Mbi licencimin e shoqërisë "S.P.E Gjadër" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Gjadër nr. 1/1" me kapacitet të instaluar 2134 kw, HEC "Gjadër nr. 1/2" me kapacitet të instaluar 4406 kw, HEC "Gjadër nr. 2" me kapacitet të instaluar 2983 kw, HEC "Gjadër nr. 3", me kapacitet të instaluar 3874 kw, HEC "Gjadër nr. 4" me kapacitet të instaluar 5922 kw, HEC "Gjadër nr. 5" me kapacitet të instaluar 5619 kw, me kapacitet total të instaluar 24938 kw	8792

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 115, datë 22.7.2019	Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 265, datë 20.12.2018, për licencimin e shoqërisë "BE – IS Energy" sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Kalivar 1", me fuqi të instaluar 1475 kw; hidrocentrali "Kalivarë 2", me fuqi të instaluar 526 kw; hidrocentrali "Kalivarë 3", me fuqi të instaluar 3321 kw; dhe hidrocentrali "Kalivarë 4", me fuqi të instaluar 275 kw, me fuqi totale të instaluar 5597 kw.....	8795
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 116, datë 22.7.2019	Mbi miratimin e "Propozimit të të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17, të rregullores së komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve"	8796
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 117, datë 22.7.2019	Mbi miratimin e një ndryshimi në "Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019.....	8798
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 118, datë 22.7.2019	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e "Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike"	8799
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 119, datë 22.7.2019	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë "GSA" sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	8803
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 120, datë 22.7.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "ENSCO Trading (Albania)" sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	8804
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 121, datë 22.7.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë "Spahiu Gjanç" sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për ndryshimin e ortakëve të shoqërisë "Spahiu Gjanç", nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të kapitalit, te shoqëria "Hydro Invest" sh.p.k.....	8805
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 122, datë 29.7.2019	Mbi miratimin e draft kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a./OSSH, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019.....	8806
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 123, datë 29.7.2019	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a. për një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik"	8813
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 126, datë 8.8.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin korrik 2019.....	8814
	Vendim *(i shkurtuar) për* shpalljen e vdekjes së shtetasit Gëzim Hajdari..	8816
	Vendim *(i shkurtuar)* për shpalljen të zhdukur të shtetasit Hysen Sadik Shehu.....	8817

DEKRET
Nr. 11252, datë 7.8.2019

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Adela Myslym Demetja
2. Migena Fiqiri Ramaliu (Gjoka)
3. Armanda Xhemali Murati
4. Viola Altin Duduci
5. Armand Ramazan Meta
6. Ervisa Lek Ndreu
7. Erdisa Tonin Dida
8. Brunilda Petrit Unruh (Haxhi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11253, datë 7.8.2019

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Veton Enver Breznica
2. Besim Jonus Shehu
3. Enise Bejtullah Shehu (Tara)
4. Januz Besim Shehu
5. Esra Besim Shehu
6. Fidan Shaban Selimi
7. Drilona Jetullah Selimi (Veliu)
8. Mentor Shaban Selimi
9. Laura Kemalj Selimi (Zabeli/Zabelaj)
10. Selman Shaban Selimi
11. Syleme Latif Selimi (Miftari)
12. Liridon Shaban Selimi
13 .Gegë Zef Lleshi
14. Fatlum Gegë Lleshi
15. Genc Musa Prelvukaj
16. Armando Xhevair Broja
17. Fatmir Zuka Matoshi
18. Burbuqe Ruzhdi Matoshi (Thaçi/Thaqi)
19. Florent Sami Muçaj
20. Fitim Sadik Sadiku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 23, datë 13.8.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008 "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Pika 77.7 e udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ndryshon si vijon:

a) Marrëveshja për pagesë me këste mund të lidhet për detyrime tatimore të vendosura nga administrata tatimore si rezultat i një vlerësimi tatimor të kryer, sipas nenit 68, të ligjit në fuqi "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", si dhe për detyrime tatimore të vetëdeklaruara (vetëvlerësimit) nga tatimpaguesi.

b) Pavarësisht sa përcaktohet në shkronjën "a", të mësipërcituar, administrata tatimore nuk hyn në një marrëveshje të pagesës me këste, vetëm për detyrim tatimor mbi të ardhurat të mbajtur në burim dhe të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, si dhe për detyrim nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tatimpaguesit.

c) Përjashtimisht, në rastet kur në cilësinë e tatimpaguesit janë institucione apo ente shtetërore apo publike, qendrore apo vendore apo ente të tjera ku shteti është palë, për raste të një interesi të lartë publik ose të nevojës për moslejimin e cenimit të rendit dhe të sigurisë kombëtare, mund të lidhet një marrëveshje me këste edhe për detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

d) Në çdo rast, për lidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste, duhet të përmbushen kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 77, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe marrëveshja nuk lehtëson pozitën ligjore të personit përgjegjës në rastet e prezumimit apo konsumimit të veprës penale së parashikuar ligjërisht lidhur me detyrimin tatimor të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 405, datë 5.8.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 5.8.2019 deri 15.8.2019, zëvendësministrit të Drejtësisë, znj. Fjoralba Caka.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Fjoralba Caka, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

VENDIM
Nr. 112, datë 22.7.2019

MBI MODIFIKIMIN E E LICENCËS SË SHOQËRISË "HENZ ENERGY" SHPK, NR. 158, SERIA PV12K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 65, DATË 28.5.2012, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et: "DARSI 1" ME KAPACITET 2240 kw, "DARSI 2" ME KAPACITET 7633 kw, "DARSI 3" ME KAPACITET 1066 kw, ME KAPACITET TOTAL 10939 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 15 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit

të ERE-S nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k, për modifikimin e licencës së shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k, nr. 158, seria PV12K, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 28.5.2012, "Për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: "DARSI 1" me kapacitet të instaluar 2240 kw, "DARSI 2" me kapacitet të instaluar 7633 kw dhe "DARSI 3" me kapacitet të instaluar 1066 kw, me kapacitet total të instaluar 10939 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 70, datë 10.5.2019, ka filluar procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k, nr. 158, seria PV12K, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 28.5.2012, "Për licencimin e shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3".

- Në vijim të vendimmarrjes sipërcituar, ERE me shkresën nr. 32/21 prot, datë 10.5.2019, ka bërë publikimin në media lidhur me fillimin e procedurës për modifikimin e kësaj licence dhe mbas përfundimit të afatit, nuk ka patur komente apo objeksione nga palë të interesuara për ndryshimet e kërkuara nga subjekti për modifikimin e licencës.

- ERE me shkresën nr. 287/1 prot, datë 14.5.2019, ka njoftuar subjektin në lidhje me vendimmarrjen e bordit.

- Modifikimi i licencës së sipërcituar, vjen si rezultat i optimizimit të skemës hidroenergjetike si dhe përmirësimit të të gjithë parametrave duke pakësuar numrin e HEC-eve nga 3 në 2, me ndërtimin e objektit konkret (Darsi 1 dhe Darsi 2) dhe rritjen e kapacitetit të instaluar respektivisht Darsi 1 me kapacitet të instaluar 3328 kw dhe Darsi 2 me kapacitet të instaluar 11635 kw.

- Shoqëria koncesionare "Henz Energy" sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, pika 1 të Kontratës Koncesionare, të lidhur ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Shqiponja-M" sh.p.k, "Iliriada" sh.p.k. dhe "Klenis" sh.p.k. dhe Autoritetit Kontraktor me nr. 286 rep. dhe nr. 39 kol, datë 30.1.2009, "Për ndërtim, operim e transferim të hidocentraleve, "Darsi 1", me kapacitet 1500 kw, "Darsi 2", me kapacitet 2700, "Darsi 3" me kapacitet 2500 kw, "Darsi 4"me kapacitet 900 kw me kapacitet total 7600 kw.

- Kjo kontratë është ndryshuar disa herë me kontrata shtesë, kryesisht për zgjatjen e afatit të vënies në shfrytëzim të HEC-eve me kontratat si më poshtë pasqyruar:

- Kontratë shtesë nr. 2164 rep. dhe nr. 268 kol, datë 20.8.2009 "Për ndryshimin e kontratës të formës "BOT", për "Ndërtim operim e transferim të hidocentraleve "Darsi 1", me kapacitet 1974 kw, "Darsi 2", me kapacitet 5844 kw, "Darsi 3" me kapacitet total jo me pak se 8902 kw";

- Kontratë shtesë koncesioni të lidhur me palët METE dhe shoqëria "Henz Energy" sh.p.k, nr. 42 rep dhe nr. 13 kol, datë 23.1.2013, "Për një shtesë afati me 14 muaj për vënie në shfrytëzim të hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3";

- Kontratë shtesë nr. 4678 rep. dhe nr. 1424/1 kol, datë 6.8.2013, "Për një shtesë afati me 16 muaj për vënie në shfrytëzim të hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3", "Për një shtesë afati me 61 muaj për vënie në shfrytëzim të hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3" "Darsi 4", të kontratës bazë të koncesionit";

- Kontratë shtesë nr. 444 rep. dhe nr. 203/1 kol, datë 6.8.2015, të lidhur midis MEI-t dhe shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k. "Për një shtesë afati me 93 muaj, jo për shkak të sajë, për vënie në shfrytëzim të hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3" "Darsi 4", të kontratës bazë të koncensionit nr. 286 rep. dhe nr. 39 kol, datë 30.1.2009;

- Kontratë shtesë nr. 711 rep. dhe nr. 302 kol, datë 25.5.2017, "Për një shtesë afati në vijim të afatit të mëparshëm me 24 muaj për vënie në shfrytëzim të hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3".

- Së fundmi është ndryshuar me kontratën shtesë të koncesionit me nr. 2105 rep. dhe nr. 1120/3 kol, datë 28.9.2018, të lidhur ndërmjet MIE-t dhe shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k, "Për një ndryshimin e kontratës të formës "BOT", për "Ndërtim, operim e transferim të hidrocentraleve "Darsi 1", "Darsi 2", "Darsi 3" "Darsi 4", e ndryshuar". Kjo shtesë kontrate vjen si rezultat i ndryshimit të projektit teknik dhe bën të domosdoshëm modifikimin e licencës, e cila lidhet

me faktin e ndryshimeve të skemës së dalë gjatë zbatimit të punimeve që bëri të mundur rritjen e parametrave të kapacitetit të instaluar dhe reduktimin e numrit të hidrocentraleve.

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 28.5.2012, shoqëria "Henz Energy" sh.p.k. është licencuar për fuqitë përkatëse si më poshtë:
- HEC "Darsi 1", kapaciteti i instaluar 2240kw
- HEC "Darsi 2", kapaciteti i instaluar 7633kw
- HEC "Darsi 3", kapaciteti i instaluar 1066kw
- Gjithsej kapacitet i instaluar **10939kw**
- Nga kontrata shtesë e koncesionit nr. 2105 rep. dhe nr. 1120/3 kol, datë 28.9.2018, rezulton se kapaciteti i HEC-eve, është si më poshtë dhe është reduktuar numri i HEC-eve nga 3 (tre) në 2 (dy) dhe me fuqitë përkatëse si vijon:
- HEC "Darsi 1", kapaciteti i instaluar 3328kw
- HEC "Darsi 2", kapaciteti i instaluar 11635kw
- Gjithsej kapacitet i instaluar **14963kw**
- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria "Henz Energy" sh.p.k, në bazë të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", rezulton si më poshtë:
- Neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c", plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 15, pika 4, germat "a", "b", "c", "d", "e", plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë "Henz Energy" sh.p.k, për modifikimin e licencës nr. 158, seria pv12k, të miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 65, datë 28.5.2012, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: "DARSI 1" me kapacitet të instaluar 2240 kw, "DARSI 2" me kapacitet të instaluar 7633 kw dhe "DARSI 3" me kapacitet të instaluar 1066 kw, me kapacitet total të instaluar 10939 kw.

2. Në përmbajtjen e licencës nr. 158, seria pv12k, të pasqyrohen ndryshimet respektive në përputhje me parashikimet e kontratës shtesë të koncesionit nr. 2105 rep. dhe nr. 1120/3 kol, datë 28.9.2018, "Për ndryshimin e kontratës të formës "BOT", për "Ndërtim, operim e transferim të hidocentraleve: "Darasi 1", "Darasi 2" dhe "Darasi 3" , si më poshtë:

Ishte:	"DARSI 1", me kapacitet të instaluar	2240 kw;
	"DARSI 2", me kapacitet të instaluar	7633 kw dhe
	"DARSI 3", me kapacitet të instaluar	1066 kw,
	me kapacitet total të instaluar	10939 kw.
Bëhet:	HEC "DARSI 1", kapaciteti i instaluar	3328 kw
	HEC "DARSI 2", kapaciteti i instaluar	11635 kw
	Kapaciteti Total i instaluar	14963 kw

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 113, datë 22.7.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "IRARBA ENERGJI" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "SHËNGJUN" ME KAPACITET TË INSTALUAR 2040 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa "a" të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1 germa "a", nenit 10, pika 1 dhe 3, 4 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë

(ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.7.2019 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Irarba Energji" sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Irarba Energji" sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC "Shëngjun" me kapacitet të instaluar 2040 kw,

konstatoi se:

- Shoqëria "Irarba Energji" sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 405, prot, datë 14.6.2019, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Shëngjun", me kapacitet të instaluar 2040 kw.

- Aplikimi i shoqërisë "Irarba Energji " sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c") është plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d" "e", "f" dhe "g") është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3; pika 4.1.4 germat: "b", "c", "d", "e"; pika 4.1.5 germat: "a", "b", "c") është plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria "Irarba Energji" sh.p.k., është një shoqëri koncesionare e krijuar në zbatim të nenit 8, të Kontratës së Koncesionit nr. 10335 rep. dhe nr. 3329 kol, datë 9.9.2013, e lidhur midis METE-s (aktualisht MIE) dhe bashkimit të shoqërive "V & A Energji Klos" sh.p.k. dhe "AGRI Construction" sh.p.k. për ndërtimin e HEC "Shëngjun", në rrethin Mat.

- Nga sa konstatuar nga Kontrata e Koncesionit të formës BOT sipërcituar, kohëzgjatja e saj do të jetë 35 vjet nga data e efektive, me të drejtë ripërsëritje.

- Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, në nenin 10, pika 4, parashikon se: ERE-ja mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4, të nenit 8, të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

- Në pikën 4, të nenit 8, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", parashikohet se: Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes se lejeve nga institucionet e tjera.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa "d" (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të shoqërisë).

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Po ashtu shoqëria duhet të dokumentojë në ERE edhe kredinë bankare të parashikuar në masën 70 % sipas Planit të Biznesit.

- Neni 9, pika 4.1.5, germa "c" (leje mjedisore). Shoqëria ka depozituar në ERE aktin e miratimit të lejes së mjedisit të tipit B, me nr. 7488 prot, datë 3.7.2014, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, lëshuar për shoqërinë "Irarba Energji" sh.p.k, për ndërtimin e HEC "Shëngjun" me kapacitet të instaluar 750 kw, me prodhim vjetor energjie 5 423 062 kwh/vit. Duke qenë se kjo leje rezulton të jetë lëshuar përpara miratimit të kontratës shtesë të koncesionit nr. 240 rep. dhe nr. 86 kol, datë 5.4.2016, "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e HEC-it "Shëngjun", e ndryshuar, të lidhur midis MIE-s dhe "Irarba Energji" sh.p.k., me anë të së cilës janë ndryshuar të dhënat që kanë të bëjnë me kapacitetin e instaluar të HEC-it, sasinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe vlerën e investimit, do t'i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE lejen mjedisore të rinovuar në zbatim të ndryshimeve që ka sjellë kjo kontratë. Gjithashtu do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë në ERE,

brenda afateve dokumentacionin e munguar të konstatuar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Irarba Energji" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Shengjun" me kapacitet të instaluar 2040 kw, për një afat 29 vjet e 1 muaj.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 114, datë 22.7.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "S.P.E GJADËR" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "GJADËR NR. 1/1" ME KAPACITET TË INSTALUAR 2134 kw, HEC "GJADËR NR. 1/2" ME KAPACITET TË INSTALUAR 4406 kw, HEC "GJADËR NR. 2" ME KAPACITET TË INSTALUAR 2983 kw, HEC" GJADËR NR. 3", ME KAPACITET TË INSTALUAR 3874 kw, HEC" GJADËR NR. 4" ME KAPACITET TË INSTALUAR 5922 kw, HEC" GJADËR NR. 5" ME KAPACITET TË INSTALUAR 5619 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 24938 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa" a", të ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, si dhe nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a" dhe nenit 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.6.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "S.P.E Gjadër" sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikqyrjes për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "S.P.E Gjadër" sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC "Gjadër nr. 1/1" me kapacitet të instaluar 2134 kw, HEC "Gjadër nr. 1/2" me kapacitet të instaluar 4406 kw, HEC "Gjadër nr. 2" me kapacitet të instaluar 2983 kw, HEC "Gjadër nr. 3", me kapacitet të instaluar 3874 kw, HEC "Gjadër nr. 4" me kapacitet të instaluar 5922 kw, HEC "Gjadër nr. 5" me kapacitet të instaluar 5619 kw, me kapacitet total të instaluar 24938 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 48, datë 27.3.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "S.P.E Gjadër" sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: " HEC Gjadër nr. 1/1" me kapacitet të instaluar 2134 kw, " HEC Gjadër nr. 1/2" me kapacitet të instaluar 4406 kw, " HEC Gjadër nr. 2" me kapacitet të instaluar 2983 kw, " HEC Gjadër nr. 3" me kapacitet të instaluar 3874 kw, " HEC Gjadër nr. 4" me kapacitet të instaluar 5922 kw, " HEC Gjadër nr. 5" me kapacitet të instaluar 5619 kw me kapacitet të instaluar total 24938 kw, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 32/11 prot., datë 27.3.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezulton të ketë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "S.P.E Gjadër" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE, me shkresën nr. 195/1 prot, datë 27.3.2019, ka përcjellë pranë shoqërisë kërkesën për

plotësim të dokumentacionit të munguar, i cili konsiston si më poshtë:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2):

- germa "d" (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë),

- germa "e" (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca),

- germa "g" (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjetet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti);

- neni 9, pika 3, germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);

- Dokumentacioni teknik dhe grafik (neni 9, pika 4.1.3):

- germa "c": shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastre) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1:25000.

- Shoqëria "S.P.E Gjadër" sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 195/2 prot, datë 18.4.2019, ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të munguar dhe në këto kushte, ERE-ja me shkresat nr. 195/3 prot, datë 6.5.2019 dhe nr. 195/5 prot, datë 27.5.2019, ka vijuar kërkesat për plotësim dokumentacioni. Shoqëria "S.P.E Gjadër" sh.p.k, ka plotësuar dokumentacionin e mbetur me shkresat nr. 195/4 prot., datë 16.5.2019 dhe nr. 195/6 prot, datë 31.5.2019.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, raportin e Oponencës Teknike nr. 5476 prot, datë 20.5.2015, mbi projektin e zbatimit të HEC "Gjadër".

- Shoqëria ka depozituar në ERE, shkresën e ZVRPP Lezhë me nr. 5184/1 prot, datë 24.11.2015, e cila njofton shoqërinë se është regjistruar kontrata e koncesionit në pasuritë e listuara në këtë shkresë sipas numrave përkatës të pasurive, përveç pasurisë me nr. 33/9 vol 1, faqe 46, me sipërfaqe 5350 m^2, me emërtesë "arë", e cila nuk preket nga vepra. Numrat e pasurisë janë të shoqëruara me kartelat e pasurisë me përshkrimin në referencë të kontratave të koncesionit.

- Shoqëria ka paraqitur lejen e përdorimit ujor, referuar shkresës së Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 549 prot., datë 1.11.2016.

- Pas shqyrtimit në mbledhjen e bordit të ERE-s, të datës 21.6.2019, u ngritën pyetje e u lanë detyra për sqarime në lidhje me lejen e ndërtimit të lëshuar me vendimin e KKT-së me nr. 9, datë 9.9.2015, statusin e ndërtimit të veprave prodhuese, si dhe deklaratës së shoqërisë në lidhje me kërkesën që do të adresojë pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për zgjatjen e afatit të kontratës, pas zbardhjes së lejes së ndërtimit nga AZHT-ja.

- ERE më shkresën nr. 195/7 Prot., datë 25.06.2019, dërgoi pranë shoqërisë njoftimin për zhvillimin e një seance dëgjimore për të sqaruar sa më sipër.

- Në seancën dëgjimore të datës 28.6.2019, përfaqësuesi i shoqërisë sqaroi në lidhje me çështjet që lidheshin më plotësimin e kushteve të parashikuara në kontratën e koncesionit si më poshtë:

- Kontrata e Koncesionit bazë me nr.10328 rep, nr. 3322 kol, e nënshkruar më datë 9.9.2013 në nenin 10 të saj, pika 10.1, parashikon se: "Koncensionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit. Aplikimi për pajisjen me leje ndërtimi do të kryhet brenda 30 ditëve nga data e miratimit të projektzbatimit përfundimtar nga Autoriteti kontraktues. Pika 10.2: Koncensionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 18 muajve nga data e marrjes së lejes zhvillimore komplekse. Afati për pajisjen me lejen e nevojshme është jo me shumë se 18 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës së Koncesionit siç është parashikuar në dokumentet standarde të garës. Afati i punimeve është parashikuar në grafikun e punimeve në aneksin 2, bashkëlidhur. Pika 10.3: këto afate do të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktor dhe Koncensionarit nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonesës të krijuar nga subjektet shtetërore.

- Me kontratën nr. 328 rep, nr. 176 kol, datë 17.6.2015 është miratuar kontrata shtesë e koncesionit.

- Shoqëria në zbatim të nenit 10, të Kontratës së Koncesionit, ka vijuar me aplikimin për lejen e

ndërtimit e cila i është miratuar me vendimin nr. 9, datë 9.9.2015. ku në pikën 2 të kësaj leje të vendimit të KKT-së përcaktohet se: "Kusht për miratimin e lejes së ndërtimit, është pajisja me vendimin e Këshillit të Basenit Ujor për përdorimin e burimeve ujore".

- Shoqëria me tej është pajisur me Lejen e Ujit nga KKU-ja, me vendimin me nr. 14, datë 26.10.2016 dhe ka vijuar me depozitimin e saj në KKT.

- Shoqërisë i është kërkuar të riaplikojë pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, nëpërmjet platformës elektronike në zbatim të legjislacionit në fuqi, dhe siç dokumentohet në datë 12.5.2019, është kryer aplikimi nëpërmjet kësaj platforme duke kërkuar lëshimin e lejes së zbardhur të ndërtimit.

- Me zbardhjen e lejes së ndërtimit do të fillojnë dhe punimet e veprës, të cilat parashikohen të përfundojnë deri në fund të vitit 2019, pasi shoqëria ka siguruar të gjithë bazën materiale, si dhe pajisjet teknike.

Deri në fund të vitit 2019 parashikohet të ndërtohen dhe të vihen në punë 3 HEC-e.

- Aplikimi i shoqërisë "S.P.E Gjadër" sh.p.k, plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e", "f" dhe "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, pika 4.1.3, germat "a", "b", "c", "d"; pika 4.1.4, germat "a", "b", "c", "d", "e"; pika 4.1.5, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Kontrata e Koncesionit e formës BOT, e lidhur midis METE-s (sot MIE) dhe Bashkimit të Shoqërive "Ani" sh.p.k, "Rafaelo 2002" sh.a, "Junik" sh.p.k, "Vllaznimi" sh.p.k, "S.P.E Energy" sh.p.k dhe "EUES Energy" sh.p.k, ka një afat 35-vjeçar, që fillon nga data 9.9.2013. Shoqëria ka aplikuar në ERE për pajisje me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në datën 28.2.2019. Nga analiza e afateve të llogaritura sipas kontratës së koncesionit dhe periudhës 30-vjeçare që ERE lëshon një licencë në zbatim të nenit 38, të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", rezulton se nga koha e nënshkrimit kanë kaluar 5 vjet e 10 muaj. Në këto kushte, ERE-ja mund të lëshojë një licencë për një afat deri në 29 vjet e 2 muaj për këtë shoqëri, në përputhje me periudhën e mbetur të koncesionit.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "S.P.E Gjadër" sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga: " HEC Gjadër nr. 1/1" me kapacitet të instaluar 2134 kv, " HEC Gjadër nr. 1/2" me kapacitet të instaluar 4406 kw, " HEC Gjadër nr. 2" me kapacitet të instaluar 2983 kw, " HEC Gjadër nr. 3" me kapacitet të instaluar 3874 kw, " HEC Gjadër nr. 4" me kapacitet të instaluar 5922 kw, " HEC Gjadër nr. 5" me kapacitet të instaluar 5619 kw; me kapacitet total të instaluar 24938 kw, për një afat 29 vjet e 2 muaj, me kushtin që brenda 3 muajve të dokumentojë marrjen e lejes së ndërtimit të zbardhur.

2. Në çdo rast që Autoriteti Kontraktor do të shprehet me vendim për shtyrje të afatit të ndërtimit dhe vënies në punë të veprës, shoqëria "S.P.E Gjadër" sh.p.k, t'i drejtohet ERE-s për miratimin e ndryshimeve që do të prodhojë kontrata shtesë e koncesionit.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 115, datë 22.7.2019

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 265, DATË 20.12.2018, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "BE – IS ENERGY" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et: "KALIVAR 1", ME FUQI TË INSTALUAR 1475 kw; HIDROCENTRALI "KALIVARË 2", ME FUQI TË INSTALUAR 526 kw; HIDROCENTRALI "KALIVARË 3", ME FUQI TË INSTALUAR 3321 kw; DHE HIDROCENTRALI "KALIVARË 4", ME FUQI TË INSTALUAR 275 kw, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 5597 kw

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", si dhe nenit 15 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 265, datë 20.12.2018, për licencimin e shoqërisë "BE – IS ENERGY" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Kalivar 1", me fuqi të instaluar 1475 kw; hidrocentrali "Kalivarë 2", me fuqi të instaluar 526 kw; hidrocentrali "Kalivarë 3", me fuqi të instaluar 3321 kw; dhe hidrocentrali "Kalivarë 4", me fuqi të instaluar 275 kw, me fuqi totale të instaluar 5597 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 265, datë 20.12.2018, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë "BE-IS Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Kalivar 1", me fuqi të instaluar 1475 kw; hidrocentrali "Kalivarë 2", me fuqi të instaluar 526 kw; hidrocentrali "Kalivarë 3", me fuqi të instaluar 3321 kw; dhe hidrocentrali "Kalivarë 4", me fuqi të instaluar 275 kw, me fuqi totale të instaluar 5597 kw, për një afat 30 vjeçar, me kusht që brenda 6 muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi të depozitojë në ERE kontratën shtesë të koncesionit që do të nënshkruajë me MIE-n, në zbatim të nenit 28, të kontratës së koncesionit me nr. 1659 rep dhe nr. 561/1 kol, datë 4.7.2016, për ndryshimin e parametrave teknike të HEC-eve: "Kalivare 1", "Kalivare 2", "Kalivare 3" dhe "Kalivare 4".

2. Subjekti "BE-IS Energy" sh.p.k. në përfundim të afatit 5-vjeçar të lejes së përdorimit të ujit, të paraqesë në ERE lejen e rinovuar për periudhën në vazhdim.

3. Subjekti "BE – IS Energy" sh.p.k në përfundim të afatit të kontratës së qirasë nr. 2417 prot., datë 30.12.2017, të lidhur ndërmjet saj dhe Bashkisë Pukë, "Për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor për ndërtimin e HEC-ve "Kalivare" 1, 2, 3, 4 nga shoqëria "BE-IS" sh.p.k.", të paraqesë në ERE kontratën e rinovuar në zbatim të legjislacionit në fuqi.

- ERE, me shkresën "Kujtesë" nr. 382 prot., datë 31.5.2019, iu drejtua shoqërisë "BE – IS Energy" sh.p.k,me kërkesën për informacion në lidhje me plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 1 të dispozitivit të vendimit nr. 265, datë 20.12.2018.

- Sa i përket kushtit të parë të vendosur në dispozitivin e vendimit nr. 265, datë 20.12.2018, shoqëria ka bërë me dije më herët se: MIE, me shkresën nr. 3286/10 prot., datë 30.10.2018, ka bërë me dije se: Procedurat për nënshkrimin e kontratës shtesë mes dy palëve, do të kryhet në të njëjtën kohë me paraqitjen e ndryshimit të parametrave hidroenergjetikë në përputhje me projektin e zbatimit, si dhe zgjatja e afatit të ndërtimit të veprës. Zgjatja e afatit bëhet në funksion të marrjes së lejes së ndërtimit, nga data kur merret kjo leje.

- Shoqëria "BE-IS Energy" sh.p.k me shkresën nr. 115 prot., datë 6.6.2019, protokolluar në ERE me nr. 382/1 prot., datë 7.6.2019, bën me dije si më poshtë:

Ka kryer aplikimin pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, i cili siç rezulton nga aplikimi bashkëlidhur kësaj korrespondence, është në fazën e shqyrtimit të këtij aplikimi.

Plotësimi i kushtit sa më sipër, hap rrugën për aplikimin në MIE dhe nënshkrimin e kontratës shtesë së koncesionit.

- Oponenca teknike, është realizuar nga AKBN-ja, referuar shkresave nr. 1158/3 prot., datë

11.5.2017, drejtuar MIE-s, për projektin e zbatimit të hidrocentraleve "Kalivar 1", me fuqi të instaluar 1475 kw; hidrocentrali "Kalivar 2", me fuqi të instaluar 526 kw; hidrocentrali "Kalivar 3", me fuqi të instaluar 3321 kw; dhe hidrocentrali "Kalivar 4", me fuqi të instaluar 275 kw, me fuqi totale të instaluar 5597 kw.

- AKBN-ja shprehet se projekti i zbatimit për HEC-et "Kalivare", plotëson kushtet dhe standardet e projektimit. Zgjidhjet teknike të veprave hidroenergjetike, si dhe komponimi i tyre në nyjat hidroenergjetike është dhënë drejt dhe argumentuar nga pikëpamja tekniko-mjedisore.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka miratuar këtë projekt zbatimi me shkresën nr. 132/49, datë 25.7.2017.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. nr. 265, datë 20.12.2018, si më poshtë:

Të licencojë shoqërinë "BE-IS Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Kalivar 1", me fuqi të instaluar 1475 kw; hidrocentrali "Kalivar 2", me fuqi të instaluar 526 kw; hidrocentrali "Kalivar 3", me fuqi të instaluar 3321 kw; dhe hidrocentrali "Kalivar 4", me fuqi të instaluar 275 kw, me fuqi totale të instaluar 5597 kw, për një afat 30-vjeçar, me kusht që nëse para vënies në operim të veprës nuk depoziton në ERE kontratën shtesë të koncesionit që do të lidhë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të ushtrojë aktivitetin mbështetur në kontratën e koncesionit me nr. 1659 rep dhe nr. 561/1 kol, datë 4.7.2016.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 116, datë 22.7.2019

MBI MIRATIMIN E "PROPOZIMIT TË TË GJITHË OST-ve PËR NJË METODOLOGJI TË PËRBASHKËT TË RRJETIT NË PËRPUTHJE ME NENIN 17 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2015/1222 TË DATËS 24 KORRIK 2015, QË PËRCAKTON NJË UDHËZUES MBI ALOKIMIN E KAPACITETIT DHE MENAXHIMIN E KONGJESTIONEVE"

Në mbështetje të neneve 7, 16, 19, 23, 56, 65 dhe 67, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; i ndryshuar, nenit 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, neneve 58, 62, 64 dhe 104, të Kodit të Transmetimit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017 dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe duke mbajtur në konsideratë se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a., është anëtar me të drejta të plota i Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit për Energjinë (European Network of Transmission System Operators for Electricity; (ENTSO-E), bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me propozimin e të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve,

konstatoi se:

- Me vendimin e bordit nr. 88, datë 31.5.2019, ERE ka filluar procedurat për miratimin e "Propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve".

- "Propozimi i të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015, që përcakton

një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve", u përcoll për miratim nga OST sh.a me shkresën nr. 2035 prot., datë 15.3.2019, protokolluar me tonën 228 prot., datë 18.3.2019.

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, përkatësisht neneve 7, 16, 19, 23, 56 65 dhe 67, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186 datë 10.11.2017, kapitulli IV në tërësi dhe nenit 64 të "Modeli i rrjetit për D-1 Dhe D" në veçanti; nenit 104 të "Modelet individuale të rrjetit, modelet e bashkuara të rrjetit dhe analizat e sigurisë operative".

- Ky dokument është një propozim i përbashkët i hartuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit në lidhje me krijimin e një metodologjie të modelit të përbashkët të rrjetit.

- Dokumenti i përbërë nga 24 nene me kërkesa specifike mbi modelin individual të rrjetit, skenarët, modelin e përbashkët të rrjetit, parametrat e cilësisë së MIRR-aë (Modeli Individual i Rrjetit) dhe MPRR-së (Modeli i Përbashkët i Rrjetit), blloqet baze të modelit, procesin e bashkimit të modeleve individuale, impaktin e pritur në objektivat e Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 dhe merr parasysh sigurinë operacionale, optimizimin në llogaritjen dhe shpërndarjen e kapacitetit ndërzonal duke siguruar trajtim të drejtë dhe jodiskriminues të pjesëmarrësve të tregut si dhe duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e informacionit.

- Në përputhje me vendimin e marrë nga European Network of Transmission System Operators for Electricity (ENTSO-E) dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të dhe interkoneksionet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet joanëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen gjithashtu që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

- ERE, në vijim të vendimit nr. 88, datë 31.5.2019, dhe në zbatim të nenit 26, pikat 3 dhe 5, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, me shkresën nr. 32/28 prot., datë 6.6.2019, publikoi për tre ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure. Në përfundim të afatit të njoftuar, rezultoi që nuk kishte asnjë koment apo opinion nga palët e interesuara

- Me shkresën nr. 228/2 prot., datë 13.06.2019, ERE i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, për dhënie mendimi lidhur me propozimin e mësipërm.

- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo opinioneve rezultoi se, Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës me nr. 382/2 prot., datë 2.7.2019, është shprehur se draft propozimi i të gjitha OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar .

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë "Propozimin e të gjitha OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenin 17 të rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve".

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit ne Fletore Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 117, datë 22.7.2019

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË "MARRËVESHJEN PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OSHEE SHA DHE FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE", TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 24, DATË 15.2.2017, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 58, DATË 15.4.2019

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, nenin 19, pika 2 të "Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha, dhe furnizuesve të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore "Mbi miratimin e ndryshimit të marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019",

konstatoi se:

- ERE me vendimin e bordit nr. 24, datë 15.2.2017 ka miratuar "Marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike", ndryshuar me vendimin e bordit nr. 58, datë 15.4.2019.

- ERE në vendimin e bordit nr. 91, datë 31.5.2019 "Mbi një ndryshim në "Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019", ka vendosur: Fillimin e procedurës për ndryshimin e nenit 20, pika 1 të "Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe furnizuesve të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019.

- ERE me shkresën e saj nr. 402 prot, datë 13.6.2019 ka njoftuar vendimin nr. 91, datë 31.5.2019, subjekteve si: OSHEE sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, Shoqatës "FIAA", si dhe "Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike" (AAES) duke kërkuar nga ata opinione dhe sugjerime lidhur me ndryshimin e kësaj marrëveshje, brenda 15 ditëve nga marrja dijeni.

- ERE në shkresën me nr. 32/30 prot, datë 6.6.2019, ka bërë njoftimin në median e shkruar, lidhur me vendimin nr. 91, datë 31.5.2019.

- Autoriteti i Konkurrencës, në shkresën e tij me nr. 380/2 prot, datë 2.7.2019 protokolluar në ERE me nr. 402/1 prot., datë 3.7.2019 shprehet se: Autoriteti i Konkurrencës mbasi shqyrtoi marrëveshjen e miratuar me vendimin e ERE-s nr. 91, datë 31.5.2019 konstaton se marrëveshja nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

- Duke qenë se marrëveshjet me furnizuesit, lidhen konform "Marrëveshjes TIP", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, dhe po ashtu asnjë nga palët e vëna në dijeni nuk kanë shprehur kundërshti mbi ndryshimet e propozuara, me procedurën e nisur me vendimin nr. 91, datë 31.5.2019 të bordit të ERE-s, gjykohet i arsyeshëm amendimi i "Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike", duke ndryshuar nenin 20, pika 1 (ekzekutimi nga palët) të saj.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 20, pika 1 të "Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a., dhe furnizuesve të energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019 si më poshtë:

- Neni 20.1 ndryshon, "Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe,

secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën palë dhe 1 dërgohet në ERE për dijeni".

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 118, datë 22.7.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E "RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË BALANCIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në zbatim të neneve 16, 19, 62, 98, 99 dhe nenit 100, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; nenit 19 dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 22.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me fillimin e procedurave për miratimin e "Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "OST" sh.a. nëpërmjet shkresës me nr. 3053 prot, datë 7.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 330 prot, datë 9.5.2019, ka përcjell për miratim "Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike".

- Drafti i "Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike" është hartuar nga shoqëria "OST" sh.a. me asistencën teknike të financuar nga "IFC".

- Në zbatim të detyrimit që ngarkon neni 98, pika 1, e ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe me qëllim përgatitjen e këtyre rregullave në mënyrë sa më të plotë, OST sh.a. ka përcjell për njohje dhe mendim draft-rregullat e tregut shqiptar të balancimit dhe ka zhvilluar takime pune të veçanta me palët e interesuara si: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ERE-n, KESH-in, OSHEE-në, shoqata e PPE-ve, shoqatat e Furnizuesve dhe Tregtarëve të energjisë elektrike, ku janë marrë të gjitha mendimet, qëndrimet e palëve mbi këto rregulla dhe është përpiluar drafti final.

- Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të nenit 98, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, është organi kompetent për miratimin e "Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike".

- Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike kanë për qëllim të:

a) themelojnë menaxhimin me bazë tregu të balancimit të sistemit elektroenergjetik, që operohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;

b) përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në tregun e balancimit;

c) mundësojnë përgjegjësi të qarta të balancimit për pjesëmarrësit e tregut;

d) përshkruajnë të drejtat dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimit të balancimit,

e) krijojnë një mekanizëm për përcaktimin e çmimit të shërbimeve balancuese të prokuruar nga OST, si dhe mekanizmin për llogaritjen e çmimit të shlyerjes së disbalancave dhe pagesave financiare të disbalancave për palët përgjegjëse të balancimit; dhe

f) çështje të tjera që lidhen me operimin e tregut balancues.

- Gjithashtu Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike kanë si objektiv krijimin e një mekanizmi balancues eficient, transparent dhe jodiskriminues që përcakton përgjegjësitë e balancimit dhe nxit pjesëmarrësit e tregut të kryejnë balancimin, si dhe të ofrojnë shërbime balancuese.

- Drafti i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, i paraqitur nga OST sh.a. për miratim, është i strukturuar në 11 (njëmbëdhjetë) kapituj dhe 3 anekse (tri).

- Kapitulli i parë ka të bëjë me "Dispozita të përgjithshme" ku përfshihet: Qëllimi i rregullave të tregut të balancimit të energjisë elektrike dhe objektivi i këtyre rregullave.

- Kapitulli i dytë ka të bëjë me "Bazën Ligjore", ku ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, përcakton "balancimin" si tërësinë e veprimeve dhe proceseve përmes të

cilave OST-ja operon dhe ruan frekuencën e sistemit brenda kufijve të paracaktuara të qëndrueshmërisë. Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike u hartuan si një dokument plotësues i Rregullave të Tregut sipas ligjit për sektorin e energjisë elektrike, i cili parashikon që Rregullat e Tregut do të përfshijnë balancimin e energjisë elektrike; neni 51, pika 1/b; neni 51, pika 2/c; neni 98, neni 99, pika 2 dhe neni 3 pika 59: përkufizime.

- Kapitulli i tretë ka të bëjë me "Miratimin dhe Rishikimin" ku sipas nenit 98, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, ERE-ja me propozimin e OST sh.a. dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, miraton Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, ku përfshihen rregullat për planifikimin, balancimin, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kërkesat për menaxhimin e rezervës. Këto rregulla hyjnë në fuqi ditën e miratimit të tyre nga bordi i ERE-s, duke pasur parasysh nenin 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016 "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike" dhe nenin 100, pika 3, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike ", i ndryshuar, ERE-ja duhet të marrë një vendim për shfuqizimin e "Rregullave të përkohshme për mekanizimin balancues të energjisë elektrike" në momentin e hyrjes në fuqi të Rregullave të Tregut të Balancimit të Energjisë Elektrike. Ndryshimi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit ndjek të njëjtën procedure si ajo e miratimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit ku ndryshimi i propozuar paraqitet nga OST sh.a., në ERE, për miratim ose iniciohet pas konsultimit me OST sh.a. Procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit, ku palët e përfshira në mosmarrëveshje do të përpiqen ta zgjidhin atë me mirëkuptim, dhe në rastet kur mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet, palët mund të paraqesin mosmarrëveshjen e tyre tek ERE, në përputhje me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 114, datë 8.7.2016.

- Kapitulli i katërt ka të bëjë me "Qëllimin" ku përfshihen rolet dhe përgjegjësitë e shoqërisë OST sh.a.

- Kapitulli i pestë ka të bëjë me "Balancimin e Sistemit", ku përfshihen specifikimi i masave që duhet të merren nga OST-ja në rastin e disbalancave në sistem; parandalimi i veprimeve balancuese (kompensimi i disbalancave). OST-ja do të lidhë marrëveshjet e nevojshme në përputhje me nenin 141, të Kodi të Transmetimi dhe do të implementojë proceset në përputhje me nenin 158 të tij, masat dhe rendi në të cilin duhet të zbatohen, përgjegjësia e balancimit ku nënkupton detyrimin ligjor mbi palët e lidhura për të dorëzuar skedulimet në lidhje me prodhimin, transmetimin dhe konsumin e energjisë elektrike.

- Kapitulli i gjashtë ka të bëjë me "Përkufizime të produktit", ku përfshihen katër produkte (FCR, aFRR, Mfrr, RR), balancuese që shërbejnë për të mbajtur frekuencën e rrjetit në nivelin e pranueshëm.

- Kapitulli i shtatë ka të bëjë me "Parakualifikimin", ku para hyrjes në tregun e balancimit, Ofruesi i Shërbimit të Balancimit (OShB) duhet të regjistrohet dhe të marrë certifikatën e parakualifikimi të njësive specifike duke synuar tregtimin e produkteve të veçanta të shërbimit të balancimit.

- Kapitulli i tetë ka të bëjë me "Procesin e Angazhimit mbi disponueshmërinë dhe shpërndarjen", ku OST është përgjegjëse për prokurimin e kapacitetit balancues në ankandet e angazhimit.

- Kapitulli i nëntë ka të bëjë me "Procesin e aktivizimit";

- Kapitulli i dhjetë ka të bëjë me "Faturimin dhe shlyerjen për OShB", ku përmes një platforme të përbashkët ose mjeti tjetër të miratuar, OST do t'i ofrojë OShB pas çdo dite pasuese të punës së operimit, një raport lidhur me të dhënat dhe monitorimin e disponueshmërisë së kapacitetit balancues dhe shpërndarjen e energjisë balancuese në ditën e mëparshme. Brenda dy ditëve pune pas përfundimit të një jave (që përfundon të dielën), OShB-ja mbledh vlerat nga raportet ditore dhe dërgon në departamentin e shlyerjes së OST-së faturën pro-forma javore të tij për kapacitetin balancues të kontraktuar dhe energjinë balancuese të shpërndarë. Brenda 5 ditëve pune pas marrjes së faturës pro-forma, OST do të pranojë ose refuzojë atë. Në përputhje me faturën pro-forma, fatura mund të dërgohet në Departamentin e Faturimit dhe Pagesave vetëm pasi OST-ja të ketë aprovuar faturën pro-forma.

- Kapitulli i njëmbëdhjetë ka të bëjë me "Menaxhimin e Kongjestioneve të Brendshme" ku OST-ja do të ketë detyrimin që ofertat me kohë

aktivizimi më të gjatë se 30 minuta, t'i përdorë vetëm për menaxhimin e kongjestionit. OST-ja dhe OSSH-ja duhet të deklarojnë zonën e kongjestionit. Nuk lejohen më tej transaksionet brenda zonës nëse janë arritur limitet e importit të zonës, prandaj OST-ja do të refuzojë nominimet e transaksioneve të tilla.

- Pjesë integrale e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike janë dhe anekset.

- **Modeli i Marrëveshjes së Ofruesit të Shërbimit të Balancimit (OSHB).** Kjo marrëveshje nënshkruhet ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) si mbajtës i licencës për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, në cilësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë që organizon tregun balancues për energjinë elektrike dhe Ofruesit të Shërbimit të Balancimit (OSHB), për të siguruar të drejtën për të kryer transaksione në tregun e balancimit të energjisë elektrike, të cilat do të jenë objekt i faturimit dhe pagesave, të drejtat dhe detyrimet e OSHB-së, referuar pjesëmarrjes në Tregun Shqiptar të Balancimit, janë parashikuar në Rregullat e TShB-së dhe anekset e këtyre të fundit, si dhe në legjislacionin përkatës në fuqi përfshirë dhe vendimet e ERE-s. Sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshje, OSHB-ja pranon me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit duke mbajtur parasysh se, në rast të konfliktit midis Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit dhe kësaj Marrëveshjeje, do të prevalojnë Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit.

- **Modeli i Marrëveshjes së Palës Përgjegjëse Balancuese (PPB).** Kjo marrëveshje nënshkruhet ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a), si mbajtës i licencës për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, në cilësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë që organizon tregun balancues për energjinë elektrike dhe Palës Përgjegjëse Balancuese (PPB). Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, PPB-ja bie dakord të përshtatë aktivitetet e saj me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit. Në rast të konfliktit midis Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit dhe Marrëveshjes, do të prevalojnë Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit.

- Pala Përgjegjëse Balancuese (PPB) pranon që Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit monitorohen dhe miratohen nga ERE dhe se ERE do të ketë të drejtën të imponojë dispozitat e këtyre rregullave mbi PPB-në, siç parashikohet në to.

- Specifikime të Rregullave të Operimit

- Ky është një dokument plotësues, i cili i bashkëngjitet Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit. Qëllimi i këtij dokumenti është të shpjegojë të gjithë proceset që zbatohen në Tregun e Balancimit, bazuar në përshkrimin e detajuar të veprimeve të aktivitetit, specifikimeve të aktiviteteve, si dhe kohën e çdo aktiviteti.

- OST thekson në kërkesën e saj se, implementimi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit, është parashikuar të kalojë në dy faza. Faza e parë do të jetë miratimi i këtyre rregullave dhe faza e dytë do të jetë faza implementuese (*Dry Run*). Gjatë kësaj faze OST-ja do të asistohet nga Asistenca teknike e zgjedhur prej financuesit dhe parashikohet që problematikat që do evidentohen gjatë kësaj faze do të reflektohen në propozime të mundshme për ndryshime të këtyre Rregullave që janë përcjellë për miratim dhe kërkon që:

1. Miratimin e draft "Rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike", me qëllim zbatimin e periudhës së implementimit të tyre për një periudhë testi (*Dry Run*) pa efekte financiare mbi palët.

2. Pas përfundimit të kësaj periudhe të implementimit, OST-ja do të paraqesë në ERE, për miratim, rregullat përfundimtare të tregut të balancimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i materialit vërejmë se:

- Nuk përcaktohet se sa do të zgjasë koha e periudhës së testit (*Dry Run*) të implementimit, pa efekte financiare mbi palët.

- Në kapitullin 3, pika 3.2 "Hyrja në fuqi e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit" përcakton se: ".... ERE duhet të lëshojë një vendim për shfuqizimin e "Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike" në momentin e hyrjes në fuqi të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit".

- Siç parashikohet në këtë draft të depozituar nga OST sh.a., në pikën 3.3.3, flitet për ndryshime të tjera jashtë procesit të përgjithshëm të ndryshimeve: "procesi fillestar i shqyrtimit të zbatimit të rregullave të TSHB", fillon në varësi të paraqitjes nga OST në ERE të një raporti

përmbledhës mbi eksperiencën e fituar nga zbatimi i rregullave. Në këtë pikë nuk shprehet detyruese paraqitja e këtij raporti.

- Në kapitullin 4 "Qëllimi" pika 4.1.1.7 është lënë bosh pjesa për sa ditë do të pezullohet marrëveshja me OshB-në. Ndërkohë në marrëveshje në aneks është parashikuar afati 30 ditë.

- Në kapitullin 5, pika 5.6 "Çmimi i disbalancave", pika 5.6.1 shprehet se: "Kostot e prokurimit të kapacitetit rezervë mbarten në tarifë. Çdo rezultat neto për OST-n nga PPB-ja dhe shlyerja e OShB-së do të përllogariten në tarifën e vitit të ardhshëm. Të gjitha kostot e tjera të alokuara për OST për të zhvilluar, operuar dhe mirëmbajtur proceset operative që lidhen me regjistrimin e PPB, ndryshimet, dispozitat e PPB-së të mundësisë së fundit, shlyerjen e disbalancave, si dhe kosto të ngjashme mbulohen nga tarifa". Në lidhje me këtë përcaktim do të diskutohet me Ost dhe palët e interesit të shtohet shprehja "Këto kosto duhet të jenë të justifikuara dhe argumentuara", e cila bazohet te përcaktimet e "Metodologjisë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike" miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 08.11.2017.

- Në pikën 5.9.1.1 flitet për një PPB (Pala Përgjegjëse për Balancimin), të mundësisë së fundit, por nuk parashikohen kriteret e përcaktimit të tij dhe as cili është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tij. Analogjia me FMF (OSHEE aktualisht) nuk gjen mbështetje në ligj, pasi ligji nuk parashikon PPB të mundësisë së fundit, për më tepër që rolin e FMF mund ta kryejë çdo furnizues që përcaktohet si i tillë dhe jo vetëm OSHEE.

- Në pikën 5.9.3.2 përfshihet opinioni i konsulentit dhe nuk përbën një dispozitë të saktë të rregullave. Gjithashtu analogjia me FMF është e paqartë për përcaktimin e PPB së mundësisë së fundit.

- Në pikën 5.9.1.5, germa "b" ndër të tjera thuhet se për koston e PPB të mundësisë së fundit, kostot e këtij roli të përkohshëm të PPB-së, duhet të mbarten në tarifë pa përcaktuar mënyrën e llogaritjes së këtyre kostove në kushtet e PPB së mundësisë së fundit.

Nuk është parashikuar në këto rregulla mënyra e shpërndarjes së përfitimeve financiare të mundshme të OST sh.a. gjatë operimit të këtij tregu te klientët.

- ERE do të kërkojë nga shoqëria "OST" sh.a. informacion të detajuar në lidhje me të gjitha komentet dhe mendimet e mbledhura nga të gjitha palët e interesit, në fazën e konsultimeve paraprake të kryer nga OST, si dhe shkallën e përfshirjes së tyre në draft-Rregullat e Tregut Shqiptar të balancimit të energjisë elektrike" e përcjellë për miratim.

- Sa evidentuar, si dhe problematika të tjera që do të dalin gjatë fazës së shqyrtimit dhe dhënies së komenteve, do t'i kërkohet shoqërisë OST sh.a. informacion i detajuar shpjegues, si dhe do të zhvillohen konsultime me publikun për të parë shkallën e përfshirjes së komenteve dhe mendimeve të tyre në rregullat e përcjellë, që paraprijnë miratimin e këtyre Rregullave mjaft të rëndësishme për sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e "Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike" bashkë me anekset përkatëse, të propozuara nga OST sh.a. me qëllim zbatimin e periudhës së implementimit të tyre (*Dry Run*) pa efekte financiare për një periudhë kohe 6-mujore.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 119, datë 22.7.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË GSA SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "d"; nenit 5, pika 1, germa "d"; nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 9, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 22.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë "GSA" sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Konstatoi se:

- Shoqëria GSA sh.p.k., është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike që prej datës 21.12.2009, dhënë me vendim të bordit te ERE-s, nr. 102 dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s me nr. 84, datë 16.9.2014.

- Shoqëria GSA sh.p.k., ka aplikuar në ERE për rinovimin licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 437 prot., datë 5.7.2019.

- Aplikimi i shoqërisë GSA sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "e") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike (neni 16, pika 1, germa "d") është plotësuar në mënyrë korrekt;

- Në kuadër të plotësimit të kësaj kërkese të rregullores shoqëria ka paraqitur në ERE sasitë e parashikuara për të furnizuar si më poshtë:

- 294 GWh në vitin 2019;
- 294 GWh në vitin 2020;
- 294 GWh në vitin 2021;
- 350 GWh në vitin 2022;
- 350 GWh në vitin 2023.

Ka paraqitur listën e kontratave të mëparshme të realizuara:

Shoqëria GSA sh.p.k., ka paraqitur në formë listë tabelore kontratat e furnizimit që ka aktualisht me disa prej kompanive prezente në tregun shqiptar të energjisë elektrike, si: "Kid – Alb, 2AT" sh.p.k., Fresh sh.p.k., Confort sh.p.k., "ALFA" sh.p.k., në nivelin e tensionit 35kV. Gjithashtu, kjo shoqëri numëron eksperienca ndër vite edhe me shoqëri të tjera, si: "Albchrome" sh.p.k., "Fushë Kruje Cement Factory" sh.p.k., "Kurum International" sh.a., "Colacem AlbanIA sh.p.k., "ARMO" sh.a. dhe "Energji Ashta" sh.p.k. dhe shprehet se mbetet në dispozicion për çdo qartësim apo plotësim të nevojshëm.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës, të shoqërisë shoqërisë "GSA" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

1.

VENDIM
Nr. 120, datë 22.7.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ENSCO TRADING (ALBANIA) SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "d" të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për licencimin e shoqërisë "ENSCO Trading (Albania)" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "ENSCO Trading (Albania)" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 438 prot., datë 5.7.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë "ENSCO Trading (Albania)" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "e ") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 germat "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa "d " (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa "a" (vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Në përputhje me veprimtarinë për të cilën kërkohet licenca, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "ENSCO Trading (Albania)" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 121, datë 22.7.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË SPAHIU GJANÇ SHPK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ANA E ERE-s, PËR NDRYSHIMIN E ORTAKËVE TË SHOQËRISË SPAHIU GJANÇ, NËPËRMJET SHITJES SË 100% TË KUOTAVE TË KAPITALIT, TE SHOQËRIA HYDRO INVEST SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, pikës 5.2 të "Licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike" miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016 dhe pikës 6.2 të "Licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, si dhe nenit 15 të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë "Spahiu Gjanç" sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për ndryshimin e ortakëve të shoqërisë "Spahiu Gjanç" sh.p.k., nëpërmjet shitjes se 100% të kuotave të kapitalit,

Konstatoi se:

- Shoqëria "Spahiu Gjanç" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 416, datë 21.6.2019, ka përcjellë kërkesën për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, në lidhje ndryshimin e ortakëve të shoqërisë, përmes shitjes së 100% të kuotave me vullnetin e saj të lirë tek shoqëria "Hydro Invest" sh.p.k.

- ERE me shkresën nr. 416/1 prot., datë 3.7.2019 iu drejtua shoqërisë "Spahiu Gjanç" sh.p.k., duke i kërkuar të plotësojë dokumentacionin e munguar për shqyrtimin e kësaj kërkese e që konsistonte në:

- Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme për shitjen e 100% të aksioneve.

- Miratimin e dhënë nga MIE për shitjen e 100% të aksioneve.

- Dokumentacionin e shoqërisë blerëse të aksioneve "Hydro Invest" sh.p.k., si aktin e themelimit; statutin; certifikatën e regjistrimit në QKB.

- Shoqëria "Spahiu Gjanç" sh.p.k., në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 416/2, datë 8.7.2019, plotësoi sa kërkuar.

- Shoqëria "Spahiu Gjanç" sh.p.k., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më 23.9.2003 dhe regjistruar pranë QKB-së, në datën 15.1.2004, me ortakë z. Dalip Spahiu dhe z. Faik Bruçi, zotërues respektivisht nga 50% të kuotave të kapitalit dhe është mbajtëse e licencës nr. 11, seria PV03K, së miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 20, datë 19.12.2003, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i "Gjanç" me kapacitet të instaluar 3.7 mw, për një afat 30-vjeçar; licencës nr. 224, seria T14P, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 14, datë 3.3.2014, së veprimtarisë të tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 20 vjeçar.

- Shoqëria "Hydro Invest" sh.p.k., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në QKB në datën 27.5.2019, me objekt veprimtarie, zhvillimin e impianteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, menaxhimin dhe drejtimin e tyre si dhe shitjen e energjisë etj., ka ortak të vetëm shoqërinë italiane LUMI SR, e cila është një shoqëri e regjistruar pranë regjistrit të biznesit në Genova, me nr. 02612700993, numër REA GE- 498970, datë 16.5.2019, zotëruese të 100% të aksioneve të shoqërisë "Hydro Invest" sh.p.k.

- Vendimi i datës 5.7.2019, i Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Spahiu Gjanç" sh.p.k., ka miratuar me unanimitet shitjen e 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare "Spahiu Gjanç" sh.p.k., me NUIS: K413160030, me seli në Korçë, Mollaj Gjanç, Godine 1-katëshe, përballë N/stacionit 35 Kwh, nga ortaket e saj Dalip Spahiu dhe Faik Bruçi (Shitësit) në favor të shoqërisë së të drejtës shqiptare Hydro Invest sh.p.k., me NUIS L91727018T, me seli, Njësia Bashkiake nr. 5, rruga "Emin Duraku", pallati "Binjakët", nr. 5, Tiranë, Shqipëri (Blerësi);

- Pas ndryshimit të ortakëve nëpërmjet shitjes së kuotave, shoqëria "Hydro Invest" sh.p.k., mbetet ortak i vetëm i 100% të kuotave të shoqërisë koncensionare "Spahiu Gjanç" sh.p.k.

- Shoqëria Koncensionare "Spahiu Gjanç" shpk, do të vazhdojë të jetë subjekti i vetëm

mbajtës i licencës së lëshuar nga ERE dhe i gjithë aseteve të hidrocentralit Gjanç, sipas Kontratës së Koncesionit deri në përfundimin e saj.

- Shoqëria "Spahiu Gjanç" sh.p.k., ka kryer pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për ndryshimin e ortakëve të shoqërisë "Spahiu Gjanç" sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të kapitalit, tek shoqëria "Hydro Invest" shpk.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 122, datë 29.7.2019

MBI MIRATIMIN E DRAFT KONTRATËS NDËRMJET "KESH SHA DHE OSHEE SHA/OSSH, PËR SHIT-BLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2019–31.12.2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, germa "h", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; neneve 104 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative"; nenit 5 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" i ndryshuar; nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, lidhur me "Miratimin e kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019"

konstatoi se:

- Me vendimin e bordit nr. 90, datë 31.5.2019, ERE, pas kërkesës së KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a, nëpërmjet shkresave nr. 2264/1 prot, dhe nr. 2264 prot, datë 13.5.2019, protokolluar me nr. 340/1, datë 15.5.2019 dhe nr. 340, datë 15.5.2019 filloi procedurat për miratimin e Kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019".

- ERE me shkresën me nr. 340/2 prot, date 13.6.2019 u ka kërkuar palëve informacion për ndryshimet e konstatuara në nenin 4 të kësaj kontrate, nga ajo e miratuar me vendimin e ERE-s nr, 98 datë 30.4.2018, e lënë në fuqi me vendimin e bordit të ERE-s nr. 16, datë 18.2.2019.

- KESH sh.a. me shkresën nr. 340/5 prot, datë 12.7.2019 drejtuar ERE-s dhe për dijeni OSHEE sh.a. është shprehur lidhur me arsyet e ndryshimeve të konstatuara në nenin 4 të kontratës, në krahasim me parashikimet e kontratës së miratuar me vendim të ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, lënë në fuqi me vendim të ERE-s nr. 16, datë 18.2.2019. KESH sh.a. shprehet se përgjatë zbatimit të kësaj kontratë në periudhën 1.1.2018–31.12.2018, nga ana e palëve është parë e nevojshme që çështje të faturimit të saktësohen dhe se këto ndryshime lidhen edhe me përmbushjen e kontratës tjetër që ekziston mes palëve, atë të shit-blerjes së energjisë elektrike për plotësimin e

kërkesës për energji elektrike të klientëve fundorë që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit.

- ERE me shkresën me nr. 340/3 prot, datë 13.6.2019, u njoftoi vendimin e bordit nr. 90, datë 31.5.2019 subjekteve si: Ministria e Ekonomisë dhe Financave; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës, duke kërkuar prej tyre të shprehin opinione apo komente rreth këtij vendimi, brenda 15 ditëve nga marrja dijeni.

- Autoriteti i Konkurrencës në shkresën e tij me nr. 381/2 prot, datë 2.7.2019 protokolluar në ERE me nr. 340/4 prot, datë 3.7.2019 ka shprehur opinionin e tij duke cituar se: "Kontrata me kushtet e saj e dakordësuar mes palëve: KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, date 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" i ndryshuar".

- Në zbatim të nenit 20, germa "h", të ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", ERE është organi kompetent për miratimin e kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019".

- Dakordësia e palëve mbi "Kontratën ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019", është shprehur nëpërmjet nënshkrimit nga palët.

- Asnjë nga palët e vëna në dijeni nuk ka shprehur kundërshti mbi ndryshimet e propozuara nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a, lidhur me procedurën e nisur me vendimin nr. 90, datë 31.5.2019 të bordit të ERE-s,

- Palët me vullnetin e tyre, kanë parashikuar shtrirjen e fuqisë juridike të kësaj kontrate nga data 1.1.2019 deri në 31.12.2019.

- KESH sh.a. ka deklaruar në mbledhjen e bordit të datës 29.7.2019, se periudha e mbuluar nga kontrata e vitit 2018, lënë në fuqi me vendimin e ERE nr. 16, datë 18.2.2019, deri në miratimin e kontratës së vitit 2019, nuk ka prodhuar efekte financiare për palët, e në të tilla rrethana me hyrjen në fuqi të kontratës së vitit 2019, nuk do të ketë nevojë për rakordime e korrigjime mes palëve për periudhën 1.1.2019–29.7.2019.

- Bordi i ERE me vendimin nr. 16, datë 18.2.2019, ka vendosur mes të tjerave:

1. Shtyrjen e afatit të zbatimit të Kontratës për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 98, datë 30. 4.2018, deri në paraqitjen e draftkontratës për vitin 2019 nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. dhe miratimin e saj nga ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. "Miratimin e kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019" (me nr. 2264/1 prot, datë 13.5.2019 të paraqitur nga KESH sh.a. dhe me nr. 10572/1 prot, datë 13.5.2019 të paraqitur nga OSHEE sh.a. (bashkëlidhur).

2. Shfuqizimin e pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s me nr. 16, datë 18.2.2019 "Mbi shtyrjen e afatit të zbatimit të Kontratës për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018."

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që nga data 1.1.2019.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Nr. 2264 prot, datë 13/05 2019

Nr. 10572 prot, datë 13/5 / 2019

Kontratë ndërmjet KESH sh.a dhe OSHEE sh.a/OSSH për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019-31.12.2019

E lidhur sot me datë ___.___.2019, ndërmjet:

Korporates Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a., rregjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqvsor Tiranë, me seli në Rr."Viktor Eftimiu", Blloku Vasil Shanto, Tiranë, Shqipëri, me NIPT-i J61817005F, e përfaqësuar nga Z. Benet Beci, Administrator i Shoqërisë KESH sh.a., që më poshtë do të quhet "**Shitësi"**,

dhe

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, (OSHEE sh.a/OSSH), rregjistruar si person juridik me vendimin Nr.38587, datë 19.06.2007, te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Bulevardin "Gjergj Fishta",Ndërtesa Nr.88 H.1, Njesia Administrative Nr.7,1023 Tiranë, Shqipëri, me NIPT-i K72410014H, përfaqësuar nga Z. Adrian ÇELA, Administrator i shoqërisë OSHEE sh.a., që më poshtë quhet "**Blerësi**",

(të cilët do të referohen veç si më sipër së bashku si "Palët" dhe me vete si "Pala")

Baza ligjore: Ligji Nr.43/2015, "Per sektorin e energjise elektrike", Vendimi Nr.244, datë 30.03.2016, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" i ndryshuar, Vendimi i Bordit të ERE Nr.139/2016 "Për miratimin e rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike", i ndryshuar, Vendimi i Bordit të ERE Nr.193/2017 "Për miratimin e rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike", Ligji nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare" i ndryshuar, ", Vendim i Bordit të ERE nr. 264, dt. 20.12.2018 " Mbi vendosjen e periudhës tranzitore për bërjen efektive të transferimit të licensave të operimit të sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike , të Shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE SH.A) tek shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a (OSSH SH.A); licensës së furnizimit energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të Shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE) sh.a, tek Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a (FSHU sh.a),

- Në kushtet kur në pikën 4, të nenit 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.244, datë 30.03.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar, parashikohet se: "Sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas pikës 2, të këtij neni, i shitet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit mesatar të Bursës Hungareze, HUPX, për periudhën në të cilën është kryer lëvrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë, siç publikohet në website-in e kësaj

burse dhe përcaktohet, në mënyrë të detajuar, në kontratë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet. Kontrata ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe prodhuesit të energjisë elektrike miratohet nga ERE";

Palët bien dakort si më poshtë vijon:

Neni 1
Objekti i Kontratës

KESH sh.a., i cili më poshtë do të quhet "Shitësi/Furnizuesi" dhe OSHEE sh.a/OSSH (në funksionin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) që më poshtë do të quhet "Blerësi", lidhin dhe nënshkruajnë këtë kontratë me objekt shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019-31.12.2019.

Neni 2
Detyrimet Kryesore të Palëve

1. OSHEE sh.a/OSSH, përpara çeljes së procedurës së blerjes në treg të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, do të njoftojë KESH sh.a. për sasinë e energjisë elektrike që ka planifikuar të blejë për mbulimin e humbjeve në rrjet, duke i kërkuar me këtë rast KESH sh.a informacion mbi mundësinë që kjo e fundit ka për të furnizuar sasinë e energjisë elektrike që kjo e fundit mund ti shesë për mbulimin e tyre, sasi e cila mund të mbulojë pjesërisht apo plotësisht kërkesën per mbulimin e humbjeve.

   KESH sh.a., përpara çeljes së procedurave të shitjes se energjisë elektrike, pasi ka përmbushur detyrimin kontraktual për FSHU për furnizimin e klienteve fundore, do ti komunikojë shoqërisë OSHEE sh.a mundësinë e furnizimit me energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa kjo e fundit duhet të konfirmojë brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KESH-it pranimin ose jo te sasisë se energji elektrike te ofruar nga KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve.
2. Nëse të dyja palët bien dakord për shitjen/lëvrimin e plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, atëherë programimet, nominimet, konfirmimet, lëvrimi dhe matja do te bazohen ne Rregullat në fuqi të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim.

Neni 3
Çmimi

Çmimi për livrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontrate do të jetë çmimi mesatar i burses hungareze HUPX per periudhen ne te cilen eshte kryer levrimi i energjise elektrike per produktin/profilin band, sic publikohet ne website-in e kesaj burse.

Neni 4
Faturimi dhe Pagesa

1. Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një faturë sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasitë totale të Energjisë Elektrike të programuar/konfirmuar nga shitësi dhe blerësi për mbulimin e humbjeve në sistemin shpërndarjes. Paraqitja e fatures do të bëhet brenda datës 5 të Muajit pasardhës të periudhës së livrimit të energjisë elektrike (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës). Krahas faturës, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit edhe të dhënat shoqeruese që lidhen me faturimin.
2. Bleresi brenda dates 20 te muajit pasardhes të livrimit ë energjisë elektrike, duhet ti dergoje shitesit informacion mbi sasine faktike të energjisë elektrike te shitur për mbulimin e humbjeve në sistemin shpërndarjes, me qellim sistemimin e veprimeve ne perputhje me parashikimet e kontratës per shiblerjen e energjise elektrike per plotesimin e kerkeses per energji elektrike te klienteve fundore qe

perfitojne nga Sherbimi Universal i Furnizimit. Palët pas marrjes së të dhënave, nëse është e nevojshme, do të bëjnë sistemimin e veprimeve referuar destinacionit te energjisë elektrike të furnizuar.

3. Pagesa e faturës nga ana e blerësit, do të bëhet brenda 30 diteve kalendarike nga dita e lëshimit të faturës përkatëse nga ana e shitësit dhe nëse dita e fundit nuk është Dite Pune, ditën tjeter të punës.
4. Vonesa në kryerjen e pagesës; Nëse Blerësi dështon në kryejen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas sipas legjislacionit në fuqi. Në llogaritjen e kamatëvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa.

Neni 5
Mos-Performanca Për Shkak të Forcës Madhore apo pamjaftueshmërisë së plotësimit të kërkesës për klientët tariforë

1. Përveç se kur specifikohet ndryshe, "Forcë Madhore" për qëllimet e Kontrates do të thotë një ngjarje jashte kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("Pala Pretenduese") që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit, për shkaqet e mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
    a. defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose
    b. pezullimi nga OST-ja përkatëse te livrimit, pranimit ose injorimit prej saj te detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.
    c. defektet apo ndërprerjet në rrjetin e shpërndarjes.
    d. defektet apo ndërprerjet në sistemin e gjenerimit të KESH sh.a.
2. KESH sh.a. nuk do të shesë/levroje energji elektrike për OSHEE sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në kushtet kur e ka të pamundur plotësimin e sasise kontraktuale me FSHU për furnizimin e klienteve fundore.
3. Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore apo pamundësisë objektive të përcaktuara në këtë kontratë, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasitë e palivruara ose të pamarra.
4. Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimit të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
5. Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcë Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.
6. Në rast të mos lëvrimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Shitësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Shitësi, në rastin kur nuk shfajësohet nga Forca Madhore, sic përcaktohet në këtë nen, do ti paguajë Blerësit një shumë për sasinë e moslëvruar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e cmimit ndërmjet cmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe cmimin më të lartë, nëse ka një të tillë, me të cilin Blerësi e ka blerë ose do ta blinte sasinë e palëvruar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do ti shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentura.

7. Në rast të mos pranimit të plotë apo të pjesshëm të energjisë elektrike nga ana e Blerësit sipas sasisë së përcaktuar ndërmjet palëve, Blerësi, në rastin kur nuk shfajësohet nga Forca Madhore, sic përcaktohet në këtë nen, do ti paguajë Shitësit një shumë për sasinë e papranuar të energjisë elektrike, të barabartë me diferencën e cmimit ndërmjet cmimit të përcaktuar në këtë kontratë dhe cmimin më të ulët, nëse ka një të tillë, me të cilin Shitësi e ka shitur ose do ta shiste sasinë e papranuar të energjisë elektrike në treg, duke vepruar në një mënyrë komercialisht të arsyeshme, shumë të cilës do ti shtohen edhe kostot shtesë, të dokumentura.

Neni 6
Personat e kontaktit

1. Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme me email ose faks:

Për Furnizuesit të Shërbimit Universal	**Për KESH**
Administratori i Kontratës	
Z/Znj. Etleva Joti (AGOLLI) Funksioni Drejtor Operacional/DTE Adresa Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane. Mob:+ 355694140008 E-mail: Etleva.agolli@oshee.al	Z/Znj Erideta Bashi Drejtori i Departamentit të Operacioneve Tregtare Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Tel.: + 355 4 2241981/249 Mob:+ 355696052851 Fax: + 355 4 2232046 E-mail: dot@kesh.al ;
Programimi	
Z/Znj Ermira Staka Funksioni: Specialist/Drejtoria e Blerjes se Energjise ne treg te rregulluar/DTE. Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane. Mob:+ 355694147922 E-mail: ermira.staka@oshee.al	Z/Znj Rakela Llanaj Përgjegjës, Sektori I Administrimit të Transaksioneve Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Tel.: + 355 4 2241981/263 Mob:+ 355694033490 Fax: + 355 E-mail: scheduling@kesh.al
Back Office	
Z. Ceno Klosi Funksioni Drejtor i Departamentit Ekonomik Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane. Mob:+ 355694145377 E-mail: ceno.klosi@oshee.al	Z/Znj Ina Malaj Përgjegjës, Sektori i Administrimit të Kontratave Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Tel.: + 355 4 2241981/263 Mob:+ 355698025300 Fax: + 355 4 2232046 E-mail: backoffice@kesh.al

Neni 7

Legjislacioni në Fuqi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Legjislacioni në Fuqi: Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontratë do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi të RSH.
2. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve: Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontraten do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë gjithashtu zbatimin nga Gjykata të të drejtave të saj kontraktuale. Gjykata kompetente është gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë.

Neni 8

Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme

1. Kjo Kontrate, dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga ERE dhe do ti shtrijë efektet nga dt. 01.01.2019.-31.12.2019
2. Ajo mund të përfundohet, ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së mbarimit të saj, vetëm me miratimin nga ERE.

Neni 9

Kjo kontratë nënshkruhet në 5 (pesë) kopje të barazvlefshme, 3 (tre) kopje KESH sh.a. dhe 2 (dy) për OSHEE sh.a.

kesh
Energji e pastër që na shkëlqen!
KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE

Bener BEGA
ADMINISTRATOR

KESH TIRANË

OSHEE
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Adrian ÇELA
ADMINISTRATOR

OSHEE, sh.a.
Protokolli
Nr. 001

VENDIM
Nr. 123, datë 29.7.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OSHEE SHA PËR NJË NDRYSHIM NË "RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, germa "l" , neni 62, pika 2, nenit 69, germa "ë", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 5, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016 "Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" i ndryshuar, nenit 21, të "Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik" miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, i ndryshuar; nenit 19, germa "f" dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 29.7.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga drejtoritë teknike, mbi shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a., për një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik",

Konstatoi se:

OSHEE sh.a., me anë të shkresës nr. 14321 prot., datë 3.7.2019, protokolluar me tonën nr. 436, datë 4.7.2019, ka kërkuar në ERE një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, konkretisht në nenin 20 të saj që lidhet me pagesat dhe faturimin, duke propozuar që afatet e pagesave të jenë të negociushme nga palët.

- Ky propozim është rrjedhojë e situatave financiare me të cilat OSHEE sh.a është përballur gjatë viteve të fundit, ku për shkaqe kryesisht të situatave ekstreme hidrike, OSHEE është gjendur në vështirësi të theksuara likuiditeti.

- OSHEE sh.a., për muajt e parë të vitit 2019 është përballur me blerje të sasive të konsiderueshme të energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Shoqëria OSHEE sh.a., e ka bazuar propozimin e saj dhe në respektim të parashikimeve të "Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike", të miratuara me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016 nga bordi i ERE-s, e konkretisht tek rregullat për kontratat dypalëshe, V.I, konfidencialiteti i kontratave lirisht të negociuara, ku përcaktohet se kontratat e shitblerjes së energjisë elektrike mund të jenë të rregulluara me një përmbajtje minimale të përcaktuar nga ERE ose të jenë të parregulluara, me përmbajtje të përcaktuar nga palët nëpërmjet negociatave direkte, që respektojnë dispozitat e Rregullave të Tregut dhe aktet e tjera të miratuara nga ERE.

- Përveç analizës dhe kushteve të mësipërme financiare, propozimi i OSHEE sh.a. mbështetet edhe në faktin se shoqëritë pjesëmarrëse në procedurat e blerjes së energjisë elektrike të realizuara gjatë vitit 2019 kanë pranuar propozimin e OSHEE sh.a., për ndryshimin e parashikimit për afatin e kryerjes së pagesës, duke rënë dakord me vullnet të lirë për kryerjen e saj brenda afatit 180-ditor nga dita e fundit e lëvrimit.

- Në lidhje me sa më sipër sqarojmë se, OSHEE sh.a. edhe më herët nëpërmjet komunikimeve të vazhdueshme nisur nga situata financiare në të cilën ndodhet shoqëria, ka kërkuar që për një periudhë tranzitore për

procedurat e blerjes së energjisë në treg të parregulluar që zhvillohen nga OSHEE sh.a. deri në fund të vitit 2019, pagesa e futurës së blerjes së energjisë elektrike të bëhet nga blerësi brenda 180 ditëve nga dita e fundit e lëvrimit.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 46, datë19.3.2019 ka vendosur ndër të tjera siç përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit"... Vendosjen e një periudhe tranzitore prej 3-muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, gjatë së cilës afati i kryerjes së pagesave nga shoqëria OSHEE sh.a. për tregtarët fitues të ankandeve të shitblerjes së energjisë elektrike me qëllim sigurimin e energjisë elektrike për përmbushjen e nevojave të klientëve fundorë, mund të jetë jo më vonë se 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë elektrike...".

- Në përfundim të afatit të miratuar me vendimin sipërcituar, si dhe pas përsëritjes së kërkesës së OSHEE sh.a., për zgjatjen e periudhës tranzitore, bordi i ERE me vendimin nr. 97, datë 21.6.2019, ka pranuar kërkesën duke vendosur zgjatjen e këtij afati deri më 30.9.2019.

Sa më sipër, referuar shkresës së OSHEE sh.a. nr. 14321 prot., datë 3.7.2019, nuk i jep zgjidhje afatgjatë problematikave të cilat kanë çuar në këto vendimmarrje dhe cituar me sipër.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a. mbi një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes se energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", si më poshtë:

- Nenin 20, germa "a", ".... pagesa do të bëhet nga blerësi sipas afatit të negociuar dhe vendosur midis palëve në kontratë".

2. OSHEE sh.a. të japë sqarime që lidhen me ndryshimet e propozuara në pikën 1 të këtij vendimi, në lidhje me kushtet e shpalljes së ofertës për blerjen e energjisë elektrike si dhe kushtet e negocimit të afatit të pagesave, duke garantuar një proces të drejtë e të ligjshëm për të gjithë tregtarët pjesëmarrës.

3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a., Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 126, datë 8.8.2019

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN KORRIK 2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017 i ndryshuar; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 8.8.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit" për muajin korrik 2019,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a, me shkresën nr. 16348 prot, datë 25.7.2019 paraqiti në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kv të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2019.

- Nëpërmjet këtij aplikimi, OSHEE sh.a. kërkon që çmimi i shitjes së energjisë elektrike te klientët e FMF-së për muajin korrik 2019 të jetë 12.75 lekë/kwh .

- Llogaritjet e OSHEE sh.a, si dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja për muajin korrik 2019 sipas "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit" të rishikuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi per FMF per muajin Korrik 2019

	Korrik 2019		Aplikimi OSHEE Sh.a	Propozimi i ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
a	Cmimi maksimal I blerjes ne treg te parregulluar ose blerja nga prodhuesit me perparesi	Leke/kWh	8.46	8.46
b	Kthimi per riskun I percaktuar ne perqindje per vitin (3%)	Leke/kWh	0.25	0.25
c	**Cmimi maksimal I blerjes ne periudhen relevante**	**Leke/kWh**	**8.71**	**8.71**
d	Kosto administrative te Furnizuesit te Mundesise se Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
e	Tarifa e perdorimit te rrjetit te transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
f	Tarifa e perdorimit te rrjetit te shperndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
	Cmimi I energjise (c+d+e+f)	**Leke/kWh**	**12.75**	**12.75**

OSHEE sh.a, për muajin korrik 2019, ka zhvilluar një procedurë për blerjen e energjisë nga tregu i parregulluar, ku çmimi maksimal i blerjes së energjisë elektrike për muajin korrik 2019 prej 63.5 eur./mwh, i përket energjisë elektrike të blerë nga shoqëria EFT AG Loti 1, realizuar në datën 26.6.2019 për sasinë totale prej 66,960 mwh me një vlerë prej 4,251,960 euro ose 518,739,120 lekë.

Nga analiza e informacionit mbi procedurat e blerjes së energjisë elektrike të dorëzuar nga OSHEE sh.a. bashkëlidhur aplikimit për çmimin FMF për muajin korrik 2019, data 26.6.2019 është dita e mbylljes së procedurës së blerjes nga tregu i parregulluar për të cilën kursi i këmbimit sipas raportimeve të Bankës së Shqipërisë rezulton 1 euro= 122 lekë

- Në aplikimin për çmimin FMF për muajin korrik 2019, OSHEE sh.a. ka zbatuar me korrektesë përcaktimet e nenit 8 të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", të rishikuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 të bordit të ERE-s" për sa i përket çmimit maksimal të blerjes.

- Meqenëse çmimi i realizuar nga blerja në tregun e parregulluar (7.75 lekë/kwh) ka rezultuar më i ulët se çmimi i blerjes nga prodhuesit me përparësi (8.4582 lekë/kwh) i miratuar me vendimin nr. 8, datë 17.1.2019 "Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019" të bordit të ERE-s, ky i fundit është marrë në konsideratë nga OSHEE-ja për llogaritjen e çmimit të FMF për muajin korrik 2019.

- Shoqëria vazhdon të mos ketë ndarje të llogarive midis aktivitetit të furnizimit dhe shpërndarjes dhe nuk ka një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit dhe kostot e disbalancave për klientët e FMF.

- Gjendur në kushtet e pamundësisë së ndarjes së kostove të FMF nga ato të FSHU, për përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës) është e arsyeshme të pranojmë koston për njësi prej 1.79 lekë/kwh të paraqitur nga OSHEE sha.

- Në zbatim të detyrës së lënë nga bordi i ERE-s në mbledhjen e datës 10.7.2019, ERE risolli në vëmendjen e OSHEE sh.a. detyrat e lëna me shkresën nr. 109/3, datë 27.3.2019, lidhur me mungesën e evidentimit të kostove të disbalancave, si dhe faturimit në pik nga ana e OSHEE sh.a. për klientët që furnizohen nga FMF.

- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 14962, datë 26.7.2019 bën me dije se, për sa i përket faturimit të konsumit në tarifën Aktiv pik të klientëve në cilësinë e FMF-së, dhe në lidhje me evidentimin e kostove të administrimit dhe të disbalancave për klientët e FMF, OSHEE sh.a e ka informuar ERE mbi arsyet e faturimit në tarifën Aktive pik dhe si duhet të trajtohen (faturohen) konsumatorët të cilët kanë sistem matje të tillë që kanë sistem leximi Aktiv dhe Pik dhe jo total indeks leximi Aktiv (kwh).

- Ky argumentim i OSHEE sh.a. nuk mund të mbështesë e të legjitimojë faturime të kryera në

kundërshtim me sa parashikuar në vendimmarrjet e ERE për përcaktimin e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, që nga hyrja në fuqi e metodologjisë përkatëse.

- Për sa i përket evidentimit të kostove të disbalancave në lidhje me FMF, OSHEE sh.a. informon se, i është drejtuar të gjithë klientëve të energjisë elektrike të lidhur në rrjetin 35 kv me anë të shkresës nr. 10155 prot, datë 7.5.2019, duke kërkuar nga ky grup klientësh ngarkesën e energjisë (konsumin e energjisë elektrike në njësi/kwh që u nevojitet) në profilin ditor/orar çdo ditë për ditën pasardhëse të parashikuar, i cili duhet të dërgohet nëpërmjet *e-mailit* duke bashkëngjitur dhe formatin e kërkuar për t'u plotësuar nga këta klientë deri në fund të vitit 2019, në mënyrë që OSHEE sh.a. të vijojë me blerjen e energjisë elektrike sipas kërkesës dhe nevojave që ka secili konsumator dhe për të analizuar kostot e disbalancave të krijuara nga blerja e energjisë në treg të parregulluar.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në vendimin nr. 266, datë 21.12.2018 të bordit të ERE-s "Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria "OST" sh.a. për vitin 2019" është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: bazuar në vendimin nr. 268, datë 21.12.2018 të bordit të ERE "Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 190 datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019" është 1.5 lekë/kwh.

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përllogaritëse rezulton që, çmimi i shitjes nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2019 të jetë 12.75 lekë/kwh.

- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 14962, datë 26.7.2019 kërkon nga ERE saktësimin e periudhës nga e cila do të fillojë korrektimi i faturave për energjinë e faturuar në pik për klientin FMF.

- ERE e gjykon të drejtë zbatimin e korrektimit të faturave për energjinë e faturuar në pik për klientët FMF për të gjithë faturimet e kryera në pik për gjatë të gjithë periudhës që OSHEE sh.a. ka ushtruar funksionet si Furnizues i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në 35 kV.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 12.75 lekë/kwh për muajin korrik 2019.

2. Korrektimin në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të faturave për energjinë e faturuar në pik për klientët FMF, për të gjithë faturimet e kryera në pik për gjatë të gjithë periudhës që OSHEE sh.a. ka ushtruar funksionet si Furnizues i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në 35 kv.

3. OSHEE sh.a. të informojë ERE-n për ecurinë e zbatimit të pikës 2, të këtij vendimi, në aplikimin e radhës për miratimin e çmimit të furnizimit nga furnizuesi I mundësisë së fundit për muajin gusht.

4. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2019-3787 (1024), datë 10.7.2019, vendosi shpalljen e vdekjes së shtetasit Gëzim Hajdari, i datëlindjes 6.11.1975.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2019-3957 (1064) datë 17.7.2019, vendosi të shpallë të zhdukur shtetasin Hysen Sadik Shehu, duke caktuar si ditë të zhdukjes së tij datën 1.10.1998 dhe caktimin e shtetasit Ardian Sadik Shehu si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë